

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare
“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN
E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”
24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri

“ARBITRI MBI MOSMARRËVESHJET FINANCIARE”: NJË MODEL I RI PËR MBROJTEN E INVESTITORËVE

Emidio Tedeschini¹

Abstrakt

Në muajin janar 2017 hyri në fuqi në Itali një institucion i ri i quajtur “*Arbitri mbi mosmarrëveshjet financiare*”, parashikuar nga dekreti legjislativ nr. 130 i vitit 2015, në implementimin e Direktivës së BE-së 2013/11/BE. Krahas modeleve të tjera ekzistuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësore ndërmjet investitorëve dhe subjekteve financiare, ndër të cilat përmenden format e ndryshme të Ndërmjetësimit, ky institucion i sapokrijuar përbën një alternativë të re dhe efikase për mbrojtjen e investitorëve.

Arbitri mbi mosmarrëveshjet financiare është një strukturë e Komisionit Kombëtar Italian për Shoqëritë dhe Bursën (*Commissione Nazionale per la Società e la Borsa - CONSOB*), i cili miraton aktet nënligjore mbi funksionimin e këtij institucioni të ri dhe ofron mbështetje me anë të një sekretarie teknike.

Investitorët mund t’u drejtohen Arbitrit vetëm pasi të kenë dërguar një ankesë paraprake subjektit financiar ndaj të cilit ka lindur mosmarrëveshja. Procedura përpara Arbitrit është falas, e thjeshtë, tërësisht online dhe mbyllet në një kohë shumë të shkurtër nëse krahasohet me procedurat gjyqësore.

Ky punim dëshiron të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme rreth legjislacionit Italian mbi *Arbitrin mbi mosmarrëveshjet financiare* duke paraqitur fillimisht aspektet kryesore që lidhen me organizimin, detyrat, mënyrat e funksionimit dhe procedurën e këtij institucioni.

Në vazhdim do të analizohen arsyet e krijimit si dhe rezultatet paraprake të vitit të parë të aktivitetit të këtij institucioni, duke nxjerrë në pah si aspektet pozitive po ashtu edhe ato kritike dhe problematike.

Në konkluzion do të bëhet një krahasim me legjislacionin aktual shqiptar duke evidentuar hapësira e iniciativa të mundshme për të përforcuar përafrimin e kuadrit rregullator shqiptar me atë italian.

Fjalë kyçe: *Mosmarrëveshje financiare; Arbitrazh; Mbrojtje e investitorëve; Mbikëqyrje Financiare; Alternative Dispute Resolution;*

¹ PhD Candidate, Università degli Studi di Roma “Tor Vergata”, emidio.tedeschini@gmail.com